



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 398/5 prot.

Tiranë, më 3.10.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 682, datë 10.7.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Enklid Gjini
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për djeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datën 18.9.2023, është njoftuar vendimi nr. 682, datë 10.7.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim, z. Enklid Gjini, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afati ligjor, Komisioneri Publik, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 682, datë 10.7.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Enklid Gjini, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin, z. Enklid Gjini, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i

Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar/Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK/AKSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI¹, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Enklid Gjini”, ka referuar: [...] (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave [...].

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit² mbi kontrollin e figurës, ka referuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Enklid *** Gjini, me sqarimin se mbetemi në pritje të përgjigjes nga SHISH. AKSIK, pas kërkesës së Komisionit për përditësim, ka përgatitur raportin,³ ku referon: [...] se nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritete verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar nga përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës, në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, z. Enklid ... Gjini [...].

2.3 KLP, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit dhe pesë dosjeve penale të përzgjedhura me short, ka përcjellë pranë Komisionit raportin⁴ për analizimin e aftësive profesionale.

3. Në përfundim, Komisioni, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1 Për vlerësimin e pasurisë⁵. [...] Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit, sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se: Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Enklid Gjini ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit [...].

3.2 Për kontrollin e figurës⁶. [...] Në përfundim të procesit, në kushtet kur nga hetimi: (i) nuk u konstatuan mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave; (ii) nuk ka pasur asnjë të dhënë dhe nuk u gjend ndonjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar dhe as prova e fakte që cenojnë figurën e subjektit apo besimin e publikut sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës, të dhëna që mungojnë e të jenë paraqitur edhe në raportin e dytë të AKSIK, i cili ka ndryshuar raportin e parë, pa iu referuar ndonjë të dhënë konkrete, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit Enklid Gjini ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”. të nenit 59/1. të ligjit nr. 84/2016 [...].

¹ Shkresa e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë **4.2019.

² Shkresa e DSIK-së me nr. *** prot., datë **.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë **.6.2021, të KDZH-së.

³ Shkresa e AKSIK me nr. *** prot., datë **.6.2023, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë **.6.2023, të KDZH-së.

⁴ Raporti i KLP-së me nr. *** prot., datë **.12.2020.

⁵ Referohuni faqes 51 të vendimit.

⁶ Referohuni faqes 34 të vendimit.

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale⁷. [...] Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreu VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Enklid Gjini ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit nr. 84/2016 [...].

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, shumica e trupit gjykues⁸ të Komisionit, duke arsyetuar mbi parimin e proporcionalitetit, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale e, për këto arsye, bazuar në germën “a”, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Enklid Gjini, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë* [...].

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

6. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij, për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

7. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

8. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 682, datë 10.7.2023, të Komisionit, çmon se ai përmban shkaqe ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

9. Për sa më sipër, në konsideratë të faktit se Kolegji ka juridiksion të posaçëm dhe të vetëm për të përcaktuar kualifikimet ligjore për çështjet që i përkasin procesit të rivlerësimit, juridiksion i cili lejon Kolegjin që të përcaktojë ligjërisht çdo rrethanë fakti nën parashikimet e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 682/2023 të Komisionit.

⁷ Referohuni faqes 52 të vendimit të Komisionit.

⁸ Kryesuesi i trupit gjykues ka dalë në pakicë dhe ndan mendim të kundërt për vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe kriterit të figurës.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III. A. Kontrolli i pasurisë

10. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

11. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Enklid Gjini, ka plotësuar deklaratën e interesave privatë për herë të parë në vitin 2003, dorëzuar në ILDKPKI në datën **.3.2004, në funksionin e Oficerit të Policisë Gjyqësore. Prej muajit korrik 2004, subjekti i rivlerësimit ushtron detyrën e prokurorit, duke dorëzuar deklaratat periodike vjetore për vitet 2004-2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe Deklaratën “Vetting” (këtu e në vijim referuar si D-Vett.) dorëzuar në ILDKPKI në datën **.1.2017. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të aneksit të Kushtetutës, konstatohet si në vijim:

12. Pasuria e paluajtshme apartament banimi me sipërfaqe 53,5 m², ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, në vijim referuar si pasuria “Apartament me sip. 53 m²”.

12.1 Në D-Vetting, subjekti ka deklaruar pasurinë: “Apartament me sip.53 m²”, me çmim blerje 1.900.000 lekë – me burim kredi e datës **.12.2007, marrë në bankën ***, në shumën 20.000 euro, me objekt blerje/rikonstruksion banese. Gjithashtu, në të njëjtën kolonë, ka deklaruar rregullime-sistemime në vlerën 1.200.000 lekë, e paguar shuma 870.000 lekë, në datën **.2.2008, dhe shuma 330.000 lekë në datën **.8.2008, ku si burim kanë shërbyer tërheqje depozitash 666.297 lekë+4 340 euro në bankën ***, në datën **.1.2008; regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në datën **.12.2007, sipas kontratës së shitjes me nr.*** rep. dhe nr. *** kol., datë **.11.2007, ngarkuar me barrë hipotekore në favor të bankës *** deri në mbylljen e kredisë. Në kolonën “*vlera me shifra e fjalë*”, deklaroi 3.100.000 lekë, dhe në atë “*pjesa në %*”, 50% regjistruar në emër të Enklid dhe ***.***.

12.1.1 Në rubrikën “*Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, të së njëjtës deklaratë, subjekti ka deklaruar kredinë në shumën 20.000 euro në bankën ***, marrë në datën **.12.2007, me objekt blerje/rikonstruksion apartamenti.

12.2 Në DV-2007 (me datë të dorëzimit **.1.2008), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen pasuri “Apartament me sip. 53 m²”, me vlerën 1.900.000 lekë, me pjesë takuese 50%.

12.2.1 Në rubrikën “*Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, të së njëjtës deklaratë, subjekti deklaroi kredi në shumën 20.000 euro, për blerje apartament banimi me sipërfaqe 53 m², me detajet përkatëse.

12.2.2 Në të njëjtën deklaratë, subjekti deklaroi detyrim ndaj firmës “****” sh.p.k., për rikonstruksionin e ap. 53 m², me vlerë totale 1.200.000 lekë, me afat përfundimin e punimeve brenda 3 muajve, pa interes.

12.3 Nga aktet në dosje rezulton se me kontratë shitje me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.11.2007, në cilësinë e palës blerëse *** e Enklid Gjini, kanë blerë nga *** e ***.***, në cilësinë e palës shitëse, pasurinë me nr. *** volum **, faqe **, zona kadastrale ***, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr.***, datë **.2.2005. Në kontratën e shitblerjes, çmimi i shitjes së pasurisë është

përcaktuar në vlerën 1.900.000 lekë, likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale, ashtu edhe se sendi objekt kontrate nuk ka ves të fshehtë, si në praktikën dokumentare shoqëruese dhe në anën funksionale të saj.

12.4 Në dosje të Komisionit janë administruar nga Banka *** (sot *** Bank⁹) aktet: (i) Kontrata e Kredisë me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.12.2007, sipas së cilës kredimarrësit Enklid dhe ***.*** kanë përfituar kredinë në shumën 20.000 euro, me qëllim blerje/rikonstruksionin e një apartamenti me adresë Tiranë, me afat 10-vjeçar. Në nenin 1/1.01 të kontratës së kredisë është specifikuar se: pjesëmarrja e kredimarrëve në këtë investim është në shumën 10.000 euro; (ii) Kontratë hipoteke nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.12.2007, nënshkruar midis Bankës *** dhe Enklid e ***.*** në rolin e hipotekuesve, sipas së cilës, hipotekuesit hipotekojnë si hipotekë të nivelit të parë në favor të Bankës për pagimin e kredisë në shumën 20.000 euro, sipas kontratës ***/***, datë **.12.2007, pasurinë me nr. ***, vol. **, f. ***, ndodhur në zonën kadastrale ***, me sip. 53,5 m² (pasuria në fjalë) vlerësuar në shumën 37.000 euro; (iii) Deklaratë e thjeshtë (e panoterizuar) e datës **.10.2007, nënshkruar midis ***.*** dhe ***.***, në cilësinë e shitësve të pasurisë dhe Enklid dhe ***.*** në cilësinë e palës blerëse, sipas së cilës, shtetasit *** dhe ***.*** deklarojnë se do t'i shesin Enklid Gjini dhe ***.*** apartamentin me adresë në rr. "****", ap. **, me sip 53,5 m², për shumën 30.000 euro. Ata deklarojnë, gjithashtu, se Enklid Gjini dhe ***.*** iu kanë likuiduar shumën prej 10.000 euro dhe diferencën prej 20.000 euro do t'ua shlyejnë përmes kredisë pranë Bankës ***. Blerësit Enklid dhe ***.*** deklarojnë se do t'i blejnë ***.*** dhe ***.*** një apartament me adresë rr. "****", ap. **, me sip. 53,5 m² në shumën 30.000 euro. Ata deklarojnë, gjithashtu, se i kanë likuiduar shitësve shumën prej 10.000 euro dhe diferencën prej 20.000 euro do ta shlyejnë përmes kredisë pranë Bankës ***.

12.5 *** Bank¹⁰ konfirmon se në datën **.12.2007, nga llogaria e Enklid Gjinit, është transferuar shuma 20.000 euro, me burim kredinë e disbursuar nga kjo bankë, në llogarinë e ***.***, me përshkrimin: "*Për blerje apartamenti nga Enklid Gjini sipas kontratës së shitblerjes*", transaksioni i cili provohet edhe nga pasqyra e lëvizjeve të llogarisë në emër të subjektit Enklid Gjinit, pranë *** Bank.

12.6 Në lidhje me çmimin e blerjes së pasurisë, Komisionit i ka rezultuar, ndër të tjera, se bazuar në udhëzimin nr. 2, datë 4.4.2007, "*Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit "k", vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë për qytetin e Tiranës është 97.000 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi, rrjedhimisht, bazuar në këtë udhëzim, vlera e apartamentit do të rezultonte në shumën prej 5.189.500 lekë.*

12.7 Në përfundim të hetimit administrativ mbi këtë pasuri, Komisioni, referuar aktit "*Rezultatet e hetimit administrativ për vlerësimin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Enklid *** Gjini*" (këtu e në vijim akti "*Rezultatet e hetimit...*") i ka kaluar subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, pasi: [...] (i) *Ka mospërputhje në lidhje me çmimin e shitjes së pasurisë në kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.11.2007 dhe deklaratën e datës **.10.2007, të dyja akte të nënshkruara nga subjekti, i cili ka nënshkruar akte që përmbajnë fakte të pavërteta referuar deklaratimeve të tij;* (ii) *Ka mungesë burimesh financiare për pagesën e shumës 10.000 euro, në datën **.10.2007, sipas deklaratës së kësaj date, për shkak të një balance negative prej - 411.716 lekësh;* (iii) *Është e paqartë pse është vënë si garanci për kredinë e marrë në *** apartamenti objekt verifikimi, ndërkohë që subjekti zotëronte*

⁹ Shkresa e *** Bank me nr. *** prot., datë **.5.2023.

¹⁰ Shkresa nr. prot. ***, datë **.3.2023.

të regjistruar në pronësi të tij dhe bashkëshortes pasurinë nr. ***, apartamenti ku aktualisht jeton që prej shtatorit të vitit 2005 [...].

12.8 Subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, në parashtrimet e veta ka deklaruar se çmimi i paguar shitësit për pasurinë *objekt verifikimi* është 20.000 euro, paguar me kreditë e marrë në datën **.12.2007, dhe se vlera e pasurisë është ajo e deklaruar në Deklaratën “Vetting”: 20.000 euro, paguar me kredi + 10.000 euro/1.200.000 lekë, shpenzuar për investime rikonstruksioni, paguar me kursime familjare. Subjekti kundërshtoi përfshirjen e shumës 10.000 euro si shpenzim i tij në datën **.10.2007, duke theksuar se nuk ka pasur asnjë qëllim për mosdeklarimin apo fshehjen e shumës 10.000 euro. Ndërsa për sa i takon garancisë në bankën ***, të pasurisë *objekt verifikimi*, subjekti deklaroi se është e natyrshme të vihet garanci apartamenti pak a shumë me të njëjtën vlerë dhe jo apartamenti tjetër në pronësi, me vlerë sa dyfishi i kredisë.

12.9 Komisioni, në përfundim për këtë pasuri, lidhur me çmimin e shitjes 1.900.000 lekë, sipas kontratës së datës **.11.2007, likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale, dhe shumës 10.000 euro, referuar deklaratës së thjeshtë të datës **.10.2007, gjendur në dokumentacionin e bankës ***, ka vlerësuar¹¹ se: [...] *bazuar në sa është arsytuar si më sipër, Komisioni çmon se mospërputhjet në vlerat e çmimit të shitjes së pasurisë dhe mënyrës së likuidimit të tij, nuk mund të penalizojnë subjektin, për arsye se nuk vërtetohet dhe as nuk ka dyshime për kryerjen e deklarimeve të rreme me qëllim fshehjen e ndonjë fakti e rrethane prej tij, sidomos në kushtet kur investimi total në pasuri u vërtetua të jetë kryer me burime të ligjshme... Komisioni krijoi bindjen se kjo shumë nuk është shpenzuar nga subjekti në këtë datë, dhe se deklarata është redaktuar për efekt të marrjes së kredisë prej 20.000 euro, bazuar në marrëveshjen fillestare me shitësin e pasurisë... Komisioni krijoi bindjen se vlera në total e shpenzuar për pasurinë objekt verifikimi është 30.000 euro, aq sa është përcaktuar çmimi në deklaratën e datës **.10.2007, përpiluar pranë *** Bank. Nga kjo shumë, 20.000 euro janë paguar me kredi bankare në vitin 2007 dhe 10.000 euro/1.200.000 lekë janë paguar nga subjekti në vitin 2008, për shpenzimet e rikonstruksionit me kursime familjare të krijuara me të ardhura të ligjshme, të cilat janë deklaruar saktësisht dhe në kohë reale, sikurse subjekti pretendon... Në përfundim, Komisioni nuk gjen shkak për penalizim të subjektit për shkak të redaktimit të deklaratës së datës **.10.2007. Por, edhe nëse shuma 10.000 euro do të konsiderohej e paguar nga subjekti në këtë datë (mbi shumën 30.000 euro, shpenzuar realisht për blerjen dhe investimin në pasuri), balanca negative prej 411.716 lekësh nuk është e atij niveli që të penalizojë subjektin e rivlerësimit [...].*

12.10 Komisioneri Publik, për sa më sipër, ndan vlerësim të ndryshëm dhe e gjen të pabazuar këtë konkluzion të Komisionit, për sa vijon:

12.10.1 Fillimisht, për sa i përket vlerës së blerjes së kësaj pasurie dhe deklarimeve të subjektit lidhur me të, nga vlerësimi i akteve në dosje rezulton se, ndryshe nga deklarimi i subjektit mbi çmimin e blerjes së kësaj pasurie, në DV-2007 dhe D-Vetting, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, deklaroi se: [...] *Sqaroj se, fillimisht, është lidhur kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.11.2007, me vlerë 1.900.000 lekë, dhe kjo me qëllimin e vetëm për kalimin e pronës në emrin tonë dhe hipotekimin e saj si garanci për bankën dhe lëvrimin e kredisë. Gjithashtu, sqaroj se në momentin e përpilimit të kontratës nuk është bërë asnjë pagesë. Nga ana jonë nuk i është kushtuar rëndësi çmimit të shitjes të shënuar në kontratë (neglizhencë), pasi qëllimi i vetëm i kësaj kontrate ka qenë kalimi i pronësisë, siç u sqarua më sipër [...].*

12.10.2 Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka deklaruar: [...] *Dua të theksoj se deklarata e redaktuar para ***-së, në dt. **.10.2007, u bë pasi ne u dakordësuam me shitësin se*

¹¹ Referohuni faqeve 19-20 të vendimit të Komisionit.

vlera e shitblerjes të këtij apartamenti pas rikonstruksionit që duhej të bëhej, do të ishte 30.000 euro. Pas verifikimit të gjendjes së apartamentit të bërë nga ne, nga shitësit dhe nga shoqëria e ndërtimit “***”, rezultoi se vlera e rikonstruksionit që duhej bërë, ishte rreth 10.000 euro, pasi gjendja e këtij apartamenti ishte shumë e keqe, për shkak të lagështisë të madhe që kishte në faqen e aneksit, në faqen e dritares së sallonit, në të gjithë dhomën e gjumit, e në të gjithë tualetin, pra duhej te hapej në tulle dhe të bëhej lëvizje muresh (muri ndarës, aneks me sallon dhe lëvizja e murit të tualetit), për shkak të eliminimit të lagështisë. Në këto kushte, ramë dakord se ***.***, nga shitja do të përfitonte shumën 20.000 euro (shumë e marrë prej tij në datën **.12.2007, pas akordimit të kredisë në datën **.12.2007, fakt ky i vërtetuar nga transaksioni i kalimit nga llogaria rrjedhëse te shitësi ***.***, datë **.12.2012, pra debituar llogaria e Enklid Gjinit dhe kredituar llogaria e ***.***, “pagesë për blerje apartamenti”, në vlerën 20.000 euro), ndërsa diferenca prej 10.000 euro që do të paguhej nga ne, sipas kontratës së kredisë me objekt: “blerje/rikonstruksion banese/investim”, do të përdorej për rikonstruksionin e apartamentit, që do ta kryente shoqëria ndërtuese “***” sh.p.k. Pra, pas rakordimit me ***.***, se ai do të merrte vlerën e shitjes 20.000 euro, pasi rikonstruksioni do të kryhej nga ne, jemi paraqitur dhe kemi vënë në dijeni bankën për këtë ndryshim, e cila na propozoi se ky ndryshim do të reflektohej në kontratën e kredisë [...].

12.10.3 Për sa më sipër trajtuar, vlerësojmë se mbeti e provuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë nënshkruar disa akte, të cilat referojnë çmime/vlera të ndryshme si të paguara lidhur me këtë pasuri. Deklarimi i subjektit gjatë hetimit administrativ, se e vetmja vlerë e paguar për blerjen e kësaj pasurie është shuma 20.000 euro, me burim kredinë bankare marrë në dhjetor 2007, nuk konstatohet të jetë në përputhje, as me aktet e administruara në dosje dhe as me vetë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, si në DV-2007, ashtu dhe në D-Vett., ku referohet si çmim/vlerë e blerjes shuma 1.900.000 lekë.

12.10.4 Bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, Komisioneri Publik sjell në vëmendje se neni D i aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, për efekt të kryerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar, parashikojnë detyrimin e subjekteve për të dorëzuar një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë, dhe udhëzime të detajuara të mënyrës së deklarimit, sikurse edhe penalitete në drejtim të prezumimit të masës disiplinore të shkarkimit, nëse vërtetohet deklarim i pasaktë e i pamjaftueshëm. Referuar sa më lart, në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të njëjtën vlerë blerje pasurie prej 1.900.000 lekë, edhe në D-Vett., ndërkohë gjatë hetimit administrativ pohon se ky çmim nuk është paguar kurrë dhe nuk i është kushtuar rëndësi vlerës së vendosur në kontratë.

12.10.5 Arsyetimi i Komisionit në vendim, se: [...] deklarimi i çmimit të shitjes 1.900.000 lekë, në Deklaratën Vetting, vlerësohet se është bërë referuar pikërisht çmimit të përcaktuar në kontratë dhe jo me ndonjë qëllim të caktuar për pasqyrimin në mënyrë të pavërtetë të çmimit të blerjes [...], në vlerësimin e Komisionerit Publik, nuk gjen mbështetje në vetë deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ. Në rastin në fjalë vlerësohet se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri, duke e vendosur atë në kushtet e parashikuara në nenin 5, pika D, e aneksit të Kushtetutës.

12.10.6 Duke iu referuar këtyre rrethanave të faktit, lidhur me deklarime të ndryshme, përfshirë ato në D-Vett., konstatohet se sa kohë që në të vetmin akt ligjor të fitimit të pronësisë, siç është kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.11.2007, është përcaktuar çmimi i blerjes 1.900.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale, pasuria është regjistruar në ZVRPP nëpërmjet kësaj kontrate (titull pronësie) dhe nuk rezulton në dosje asnjë akt ligjor për ndryshimin e kontratës dhe çmimit të përcaktuar në të, Komisioni, në analizimin e burimeve të ligjshme të subjektit dhe

personit të lidhur me të, duhej të kishte marrë në analizë mundësinë e tyre për të mbuluar me burime të ligjshme shumën 1.900.000 lekë, paguar deri në datën **.11.2007. Nga kjo analizë do të rezultonte pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, prej të paktën – 1.200.000 lekë¹², duke e vendosur subjektin në kushtet e parashikuara në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

12.10.7 Nga ana tjetër, edhe në vlerësim të konsiderimit të pagesës së shumës 10.000 euro, deri në datën **.10.2007, sikundër konsideruar nga Komisioni, pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme financiare që do të rezultonte në këtë rast në vlerën negative rreth 550.000¹³ lekë, në vlerësimin e Komisionerit Publik do ta vendoste subjektin në kushtet e parashikuara në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, marrë kjo pamjaftueshmëri financiare në vlerësim tërësor me kontradiktat e deklarimeve në D-Vett. dhe me aspektet e fiktivitetit, që referohen në hartimin e praktikës dokumentare së kalimit të pronësisë së sendit.

III.B. Kontrolli i figurës dhe gjetjet në raportin e AKSIK

13. Gjatë hetimit për kontrollin e figurës, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe përditësim të raportit fillestar, ka përcjellë pranë Komisionit raportin me nr. *** prot., datë **.5.2023, me anë të cilit ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit dhe i ka referuar Komisionit se: [...] *nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës, në përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Enklid... Gjini [...].*

14. Komisioni, bazuar në informacionet e marra pranë organeve ligjzbatuese, ka verifikuar dy çështje penale, për të cilat ka krijuar korrespondencë me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, sipas të cilës rezultojnë sa vijon:

14.1 *Për procedimin penal nr. ****, viti 2005, janë administruar shkresa, sipas të cilave rezultojnë se procedimi penal ka qenë në ngarkim të shtetasit ***.***, është regjistruar dhe hetuar nga një tjetër subjekt rivlerësimi, prokurori ***.***, nuk rezultojnë të ketë zëvendësim prokurori, vendimi i pushimit të çështjes penale është marrë në datën **.11.2005, nuk rezultojnë të jetë i pasqyruar në inventarin e procedimeve penale të pushuara për vitin 2005, nuk disponohen të dhëna nëse kundër vendimit të pushimit është paraqitur ankim apo jo, dhe **se dosja e këtij procedimi penal nuk rezultojnë të jetë dorëzuar pranë zyrës së arkivit.**

14.2 *Për procedimin penal me nr. ****, viti 2015, prokuror i çështjes është subjekti i rivlerësimit. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, më datë **.9.2015, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, dhe regjistrimin e emrit të shtetasit ***.***, si person që i atribuohet vepra penale. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës **.9.2015, ka vendosur pushimin e çështjes penale me nr.***/2015, dhe në arsyetimin e vendimit referon në nenin 290/1 të Kodit Penal, ku kërkon si element të domosdoshëm të saj, minimalisht, plagosjen e lehtë të disa personave.

¹² Ky rezultat vjen si diferencë e zbritjes nga të ardhurat nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes deri në datën **.11.2007, të shumës 1.900.000 lekë, paguar deri në këtë datë, për blerjen e pasurisë *apartment*, bazuar në kontratën e shitjes datë **.11.2007, shpenzimeve të jetesës sipas përbërjes familjare të subjektit deri në këtë datë, ndryshe nga Komisioni, llogaritur bazuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit sipas korrespondencës me ILDKPKI dhe INSTAT, për vitin 2007, si dhe shpenzimeve të tjera të periudhës të evidentuara dhe nga analiza e Komisionit. Kësaj diference i shtohet dhe diferenca e vitit 2013, në shumën – 178.404 lekë, për të cilën, edhe pas prapësimeve, subjekti nuk arriti të provojë ligjshmërinë e të ardhurave nga qiraja.

¹³ Në këtë diferencë, shpenzimet e jetesës, ndryshe nga Komisioni, janë llogaritur bazuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, sipas korrespondencës me ILDKPKI-në dhe INSTAT-in, për vitin 2007.

15. Komisioni, në aktin “Rezultatet e hetimit ...”, për procedimin penal në ngarkim të shtetasit ***.***., subjektit të rivlerësimit nuk i ka drejtuar pyetje apo kërkuar sqarime. Për procedimin penal në ngarkim të shtetasit ***.***., i ka kaluar barrën e provës, duke konstatuar se: [...] *vendimi i pushimit të procedimit penal të datës *.9.2015, është në kundërshtim me provat e administruara gjatë hetimit, pasi nga Akti i Ekspertimit Autoteknik u provua shkelja e rregullave të Kodit Rrugor nga ana e personit që i atribuohet vepra penale, ndërsa nga Akt-dëshmia Mjekoligjore u provua pasoja e ardhur, që është plagosja e rëndë; - arsyetimi i subjektit në vendimin e pushimit duket se është i paqartë, pasi, përkundër sa arsyetohet në urdhrin e regjistrimit të procedimit penal për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i KP ndaj personit që i atribuohet vepra penale, në vendimin e pushimit, ai arsyeton mbi mungesën e veprës penale të parashikuar nga neni 290/1, e cila kërkon si pasojë plagosjen e lehtë të disa personave [...]. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë përgjigje në lidhje me barrën e provës në parashtrimet e datës 3.7.2023.*

16. Komisioni, për të dyja çështjet penale, ka arritur në përfundimin se: *nga analizimi i tyre nuk janë konstatuar të dhëna që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, ndërsa lidhur me procedimin penal në ngarkim të shtetasit ***.***., ka arritur në përfundimin se: [...] pavarësisht se subjekti duhet të kishte treguar më shumë kujdes në drejtim të arsyetimit të mungesës së elementeve të veprës penale, “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, ashtu sikurse ka arsyetuar në parashtrimet e veta, subjekti kundërshtoi barrën e provës sa i takon vendimmarrjes së pushimit të hetimeve, duke mirargumentuar shkaqet që e çuan në këtë vendimmarrje. Për më tepër, nga shtetasja ***.*** nuk është ushtruar ankim [...].*

17. Komisioneri Publik vlerëson se nisur nga referimi i agjencive ligjzbatuese, organe ndihmëse në kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, dy procedimet penale, objekt hetimi administrativ nga Komisioni, nuk janë hetuar plotësisht dhe në mënyrë të gjithanshme, për të përjashtuar eventualitetin e gjendjes së subjektit të rivlerësimit në kushtet e zbatimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

17.1 Konkretisht, sikurse Kolegji ka trajtuar në jurisprudencën e tij¹⁴, mbi bazën e të dhënave dhe nivelit të aksesit mbi informacionin e klasifikuar, nga ana e Komisionit duhet të analizohen dhe vlerësoheshin veprimet në kundërshtim me detyrën të subjektit për të cilat hidhen dyshime, parë këto në drejtim të elementeve që lidhen me indikatorin e integritetit, si një prej treguesve të matshëm në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit. Rezulton se ky trajtim procedural nuk ka ndodhur eventualisht me të dyja praktikatat dhe, në mënyrë të dukshme, rezulton në procedimin penal me nr. ***, viti 2005, fashikulli penal i të cilit nuk është administruar nga Komisioni, megjithëse është konstatuar fakti i mosgjetyes/mosdorëzimit të këtij fashikulli penal në sekretari, në kundërshtim me dispozitat ligjore.

17.2 Nisur nga pozita procedurale e Komisionerit Publik në procesin e rivlerësimit, referimi në përmbajtjen e materialit/informacioni i klasifikuar që administron në burim institucioni informues, në këtë rast do të transferohet në përmbajtjen e asaj pjese të vendimit të Komisionit (*prg. 5.8-5.9 i mendimit të pakicës*), ku është konstatuar se referimi i papërshtatshmërisë së subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës është i bazuar në fakte dhe rrethana konkrete. Nisur nga juridiksioni rivlerësues/kontrollues i Kolegjit, ky konstatim i fakteve i dhe rrethanave, do të duhet të vlerësohet dhe të bëhet pjesë e vendimmarrjes përfundimtare të gjykimit të këtij ankimi.

¹⁴ Referohuni vendimit (JR) nr. 27, datë 21.9.2021.

III.C. Çështje në vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve

18. Komisioneri Publik vëren se, nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, dalin çështje, të cilat kërkojnë vëmendje, për të konkluduar për konfirmimin ose jo në detyrë të subjektit të rivlerësimit, të evidentuara në kriterin e kontrollit të kriterit të pasurisë dhe atij të vlerësimit të aftësive profesionale, si në vijim.

19. Pasuria e luajtshme automjet e markës “Ford Fiesta”

19.1 Në DV-2008, subjekti i rivlerësimit deklaroi blerjen e automjetit tip “Ford Fiesta”, viti i prodhimit 1999, në vlerën 200.000 lekë, me pjesë takuese 100%, pa deklaruar burimin e krijimit.

19.1.1 Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën: “*Të dhëna konfidenciale*”, subjekti deklaroi: “*Akt përdorimi me nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë **.10.2008, për automjetin tip Ford Fiesta, me targë ***, vit prodhimi 1999, nuk është hartuar kontrata e shitjes (lekët janë likuiduar)*”.

19.2 Në DV-2016, subjekti i rivlerësimit deklaroi se automjeti “Ford Fiesta”, vit prodhimi 1999, i deklaruar në *Periodike Vjetore* të vitit 2008, ka dalë jashtë përdorimit në gusht 2016 (shkak amortizimi).

19.3 Gjatë hetimit administrativ, subjekti, z. Gjini, është pyetur, si në pyetësonin standard, ashtu edhe në pyetësonin nr. 2, dhe përgjigjet janë si në vijim:

19.3.1 Në përgjigje të pyetësonit standard [...] në **.10.2008, kam marr për përdorim nga ***.*** automjet tip Ford Fiesta, sipas Prokurës së posaçme nr. *** rep./ *** kol., për përdorim mjeti, me qëllim blerje. Shtetasen ***.*** nuk e kam njohur, të gjitha veprimet janë bërë më djalin e saj, ***.***, i cili ka qenë OPGJ në Komisariatit e Policisë nr.3, Tiranë, me të cilin kam pasur miqësi. Më pas vendosëm ta mbanim këtë automjet, duke i dhënë atij shumën 200.000 lekë, por duke qenë se pronarja e mjetit, ***.***, jetonte jashtë shtetit, nuk mundem të bënim kontratë shitblerje. Megjithëse e kishim këtë të drejtë në prokurë, nuk bëmë kontratë se do të dukej e pavend një kontratë ku do të përfaqësonim, edhe shitësin, edhe blerësin. Ky automjet është përdorur shumë pak nga ana jonë, pasi pati probleme në motor dhe, duke qenë se nuk kishim mundësi ta takonim pronaren e mjetit, nuk u konkludua me një kontratë shitblerje. Në vitin 2016, mjete ka dalë totalisht jashtë përdorimi dhe është demoluar [...].

19.3.2 Në përgjigje të pyetësonit nr. 2, kërkesës së Komisionit për të vënë në dispozicion dokumente që provojnë dhënien e shumës prej 200.000 lekë, shtetasit ***.***, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Nuk disponoj asnjë dokument, mbi dhënien e shumës 200.000 lekë, pasi e kemi të pamundur për t'i marrë deklaratë noteriale, për të vërtetuar faktin e marrjes së shumës, pasi miku dhe shoku ynë, ***.***, ka ndërruar jetë në dt.**.02.2016. Siç vërehet ky automjet ka qenë me targa italiane dhe nuk është bërë regjistrimi i tij në Shqipëri [...].*

19.4 Në dosjen të Komisionit, gjatë hetimit administrativ, në lidhje me këtë çështje, është administruar:

19.4.1 Prokurë e posaçme nr. *** rep., nr.*** kol., datë **.10.2008, sipas së cilës e përfaqësuar ***.*** autorizon shtetasit Enklid e ***.*** të kryejnë çdo veprim të nevojshëm për tjetërsimin nëpërmjet shitjes së automjetit, në pronësi të znj. ***.***, pronësinë e të cilit, sipas tekstit të prokurës, e provon me certifikatën e pronësisë së mjetit (italiane), librezën e automjetit dhe vërtetimin e hyrjes në Doganën e Durrësit, datë **.9.2008. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj prokure, iu jepet e drejta subjektit dhe bashkëshortes së tij, që mjetin ta përdorin vetë pa asnjë lloj kufizimi, brenda dhe jashtë vendit, deri në momentin e shitjes.

19.5 Komisionit, gjatë hetimit administrativ, nëpërmjet aksesimit në të dhënat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, mbi polica të sigurimit me përdorues subjektin e rivlerësimit, z. Gjini, i ka rezultuar policë sigurimi për periudhën **.10.2008-**.10.2009, për automjetin me nr. shasje ***, marka “Ford Fiesta”, me targa ***, me pronare ***.***, dhe përdorues Enklid Gjini dhe znj. ***, policë sigurime me të njëjtat të dhëna për periudhën **.03.2010 - **.03.2011, me përdorues vetëm Enklid Gjini. Për të dhënat e dala nga ky verifikim, Komisioni ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR) vënien në dispozicion të dosjes së plotë të automjetit me nr. shasje ***, me targa ***. Në përgjigje të kësaj kërkesë, DPSHTRR-ja informon se mjeti me numër shasje *** nuk rezulton i regjistruar në DPSHTRR *dhe nuk i përket targës* ***.¹⁵.

19.6 Komisioni, në aktin: “*Rezultatet e hetimit administrativ...*”, ka përshkruar çfarë ka rezultuar nga hetimi administrativ¹⁶ dhe nuk i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime apo sqarime, si dhe në vendimin objekt shqyrtimi nuk ka arsyetim dhe konkluzion lidhur me pronësinë apo përdorimin e këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit.

19.7 Komisioneri Publik vlerëson se Komisioni duhet të arrinte në kokluzion lidhur me këtë pasuri, si për përdorimin, ashtu edhe statusin e pronësisë së tij dhe, rrjedhimisht, përmbushjen e detyrimeve ligjore¹⁷ që lidhen me përdorimin apo regjistrimin e automjeteve me targa të një shteti të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë. Subjekti ka deklaruar nxjerrjen jashtë përdorimit të mjetit për shkak të amortizimit të tij në DV-2016, veprim që nuk rezulton i provuar me ndonjë akt ligjor, duke mbetur në nivel deklarativ, për më tepër që automjeti, i deklaruar dhe i përdorur prej subjektit që nga viti 2008, nuk është regjistruar asnjëherë pranë DPSHTRR-së, pavarësisht tagrave të dhëna në prokurën e posaçme nga pronari i mjetit, znj. ***. dhe as nuk është/janë kryer procedurat e zhdoganimit të tij në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, edhe deklarimet e subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit të Komisionit, mbeten në nivel deklarativ dhe i referohen vetëm faktit të pronësisë ligjore të znj. ***.*** mbi automjetin. Gjithashtu mbeten kontradiktore të dhënat që dalin nga verifikimi i Komisionit në AMF dhe përgjigja e DPSHTRR-së lidhur me targat e këtij automjeti.

19.8 Në këto rrethana, duket se qëndrimet e subjektit të rivlerësimit për këtë marrëdhënie të pronësisë/përdorimit për një periudhë shumë të shkurtër të këtij automjeti, nuk gjejnë mbështetje me përmbajtjen e akteve të administruara në dosje, duke e vendosur atë në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të fshehjes së ushtrimit të të drejtave mbi këtë send, referuar nenit D, pikat 1 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës.

20. Pasuria Autoveturë Benz, me targë ***

20.1 Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Në dt. **.10.2016 kam bërë kontratë huapërdorje makine nr. *** rep. e *** kol., për mjetin benz ***, me qëllim për ta parë si punonte e, në rast se do të më pëlqente, për ta blerë më pas. Mjetin e kam mbajtur pak ditë dhe ia kam kthyer pronarit të tij, i cili nga sa më tha, u largua për në USA. Nuk e bleva në atë moment, pasi çmimi ishte i lartë dhe kur është*

¹⁵ Shkresa e DPSHTRR-së me nr. ***, datë **.5.2023, ku vihet në dispozicion dosja e plotë e mjetit, me targë ***.

¹⁶ [...] Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit, konstatohet se: (i) blerja e këtij automjeti është deklaruar nga subjekti në DPV-2008, në çmimin 200 000 lekë; (ii) në DPV-2016, subjekti ka deklaruar daljen jashtë përdorimit për shkak të amortizimit të këtij automjeti. I pyetur në lidhje me dokumente që provojnë dhënien e shumës prej 200 000 lekësh, shtetasit ***.***, subjekti ka informuar se nuk disponon asnjë dokument mbi dhënien e shumës prej 200 000 lekë dhe është e pamundur për t’i marrë deklaratë noteriale, pasi shtetasi ***.*** ka ndërruar jetë në vitin 2016. Automjeti ka qenë me targa italiane dhe nuk është bërë regjistrimi i tij në Shqipëri. Nga verifikimet e kryera në lidhje me shtetasit ***.*** dhe ***.***, nga përgjigjet e prokurorive Tiranë, Fier dhe SPAK, nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi apo përfshirje të tyre në veprimtari të kimit të organizuar.

¹⁷ Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 10 076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

*kthyer nga USA, shitësi me kontaktoi përsëri dhe ramë dakord për një çmim të leverdishëm dhe ky mjet u ble më pas, në dt.**.04.2017, nga bashkëshortja ***.***, me kontratë shitje pasurie të luajtshme (Automjeti) nr. *** rep. e *** kol., dt.**.4.2017 [...].*

20.2 Në DV-2017, subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti me konkretisht: [...] Mercedes Benz - Daimler Chrysler, vit prodhimi 2006, me targë ***. Blerë me kontratë shitblerje nr. *** rep. dhe nr. ***kol., dt.**.4.2017, në pronësi 100 % të bashkëshortes [...].

20.3 Lidhur me këtë pasuri, në dosjen e Komisionit, ndër të tjera, janë administruar: (i) kontratë me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.10.2016, huapërdorje automjeti “Mercedes Benz”, me targa ***, lidhur ndërmjet z. ***.***, në cilësinë e huadhënësit dhe subjektit të rivlerësimit, Enklid Gjini, në cilësinë e huamarrësit, me qëllim përdorimin e automjetit në Republikën e Shqipërisë dhe në çdo shtet tjetër. Kontrata është lidhur pa afat; (ii) Kontratë shitje pasurie të luajtshme, autoveturë me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.4.2017, lidhur ndërmjet z. ***.***, në cilësinë e shitësit dhe znj. ***.***, në cilësinë e blerësit, për automjetin me targa *** në vlerën 550.000 lekë.

20.4 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, pasi ka konstatuar se: [...] *Në lidhje me shtetasin ***.***, nga verifikimet e kryera pranë Prokurorive Tiranë, Fier dhe SPAK , nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi e as përfshirje të këtij shtetasi në veprimtari të krimit të organizuar. Në lidhje me përdorimin e automjetit nga verifikimi në sistemin elektronik të AMF rezulton se për mjetin me targë ***, nga policat e sigurimit për periudhën 2017 e në vijim rezulton pronare dhe përdoruese ***.***, ndërsa përpara kësaj periudhe nga policat rezulton pronar e përdorues shtetasi ***.***. Nga verifikimi i hyrje-daljeve në sistemin TIMS të subjektit dhe shtetasit ***.*** nuk rezultuan udhëtime të përbashkëta të tyre. Pra nuk rezultojnë të dhëna që subjekti apo bashkëshortja të kenë përdorur mjetin përpara blerjes në vitin 2017. Megjithatë, referuar prokurës së posaçme, datë **.10.2016, subjekti e ka pasur mjetin në përdorim dhe duhet ta deklaronte në D-Vetting [...], i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë sqarime.*

20.5 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka deklaruar se e kanë mbajtur në përdorim automjetin për një periudhë dyjavore dhe nuk janë kujdesur për të nënshkruar akte mbi revokimin e prokurës, duke ditur që do të ishin blerësit e ardhshëm.

20.6 Komisioni arrin në përfundimin¹⁸ se: [...] *referuar periudhës 2-javore të përdorimit të mjetit deri në plotësimin e D-Vetting, faktit që në periudhën para blerjes së mjetit policat e sigurimit tregojnë pronar shtetasin ***.***, faktit që në sistemin TIMS nuk rezultuan udhëtime të subjektit apo bashkëshortes së tij me këtë automjet, si dhe faktit që automjeti i dhënë në përdorim u ble nga bashkëshortja e subjektit, pretendimet e subjektit u vlerësuan të arsyeshme dhe nuk ngrihen dyshime për shkak të mosdeklarimit të përdorimit të mjetit në D-Vetting [...].*

20.7 Komisioneri Publik, në vlerësim të akteve si më sipër dhe në referencë të kërkesave të ligjit nr. 84/2016 dhe aneksit D të Kushtetutës, mbi detyrimin që kanë subjektet e rivlerësimit për deklarimin e pasurive në përdorim në momentin e plotësimin të D-Vetting, në mungesë dhe të ndonjë akti apo dokumentacioni ligjor, për të provuar afatin e përdorimit, për sa kohë kontrata e huapërdorjes është pa afat dhe mjeti rezultoi i blerë nga subjekti në prill 2017, apo kthimin e automjetit pronarit, vlerëson se pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ dhe të paprovuara.

20.8 Lidhur me këtë pasuri dhe përdorimin e saj, në vlerësimin e Komisionerit Publik, mosdeklarimi i përdorimit të këtij automjeti në D-Vetting e bën deklarimin e subjektit të pasaktë, në kuptim të pikës 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

21. Denoncim¹⁹ i shtetasës *.***.**

21.1 Komisioni, në funksion të hetimit administrativ të denoncimit të shtetasës ***.***, ka administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë²⁰, vendimin

¹⁸ Referohuni faqes 32 të vendimit të Komisionit.

¹⁹ Protokolluar në Komision me nr.***, datë **.2.2021.

²⁰ Shkresa me nr.*** prot., datë **.6.2023.

penal nr. ***, datë **.6.2016, shqyrtim gjyqësor i procedimin penal nr. ***, i vitit 2014, që i përket shtetasë ***.***.

21.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë ka marrë në shqyrtim kërkesën për gjykim të procedimit penal me nr. ***, viti 2014, për veprën penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ku prokuror është subjekti i rivlerësimit, z. Gjini. Gjykata, me vendimin nr. ***, datë **.6.2016, ka vendosur: [...] *Pushimin e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të pandehurës ***.***, e akuzuar për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për mungesë të elementeve të veprës penale [...]. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë **.6.2016, pasi nuk u ankimua.*

21.3 Në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë vërehen arsyetimet sa vijon: (i) organi i akuzës për të pandehurën ***.*** nuk provon se cili është dëmtimi i interesave të ligjshme të shtetit, shtetasve dhe të personit juridik prej të pandehurës dhe as ana subjektive, dashja direkte ose indirekte në kryerjen e veprimeve prej saj; (ii) fakti nuk përbën veprë penale për akuzën e ngritur ndaj të pandehurës ***.***, ndaj, në bazë të nenit 387/1 të Kodit të Procedurës Penale, gjykimi i çështjes duhet të pushohet për mungesë të elementeve të veprës penale.

21.4 Komisioni, në aktin “*Rezultatet e hetimit...*”, pasi referon se është administruar nga Prokuroria Tiranë²¹, dosja e procedimit penal nr. ***, viti 2014, përshkruan kronologjikisht veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe i kërkon, ndër të tjera, të japë sqarime lidhur me sa vijon: [...] (i) nga aktet e dosjes konstatohet se mungon urdhri për zgjatjen e afatit të hetimeve për periudhën **.02.2015 – **.05.2015, dhe, në referim të dispozitave të Kodit të Procedurës penale, neni 324/4, veprimet hetimore të kryera pas mbarimit të afatit, nuk mund të përdoren; (ii) *Në lidhje me pretendimin e fundit të denoncueses, se subjekti, në kundërshtim me ligjin, nuk ka bërë ankim kundër vendimit të gjykatës, nga verifikimi i akteve të dosjes në përmbajtje të tij nuk gjendet vendimi i gjykatës dhe as ankimi i prokurorit të çështjes. Në nenin 329/3 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim nga prokurori i çështjes [...]. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë përgjigje në Parashtrimet e datës 3.7.2023.*

21.5 Komisioni, në përfundim²² ka arsyetuar se: [...] *Në analizë të parashtrimeve, sa i takon dokumentit të paraqitur nga subjekti, urdhrin për zgjatje hetimesh, i panënshkruar, Komisioni vlerëson se ai nuk përbën një akt zyrtar të përpiluar në formën e kërkuar nga ligji sipas neneve 246, 251, 253 dhe 254 të Kodit të Procedurës Civile. Nga ana tjetër, nga verifikimi në sistemin TIMS vërtetohet pretendimi i subjektit se, nga data **.2.2015 deri në datën **.3.2015, ai ndodhej jashtë vendit, në SHBA, çka vërteton faktin që në momentin që duhej të hartohej urdhri për shtyrjen e afatit të hetimeve në datën **.2.2015, ai nuk ishte duke ushtruar detyrën. Pavarësisht kësaj, Komisioni vlerëson se subjekti mund të kishte marrë masa dhe të delegonte të gjitha veprimet që duhet të kryheshin lidhur me dosjen. Megjithatë, në vlerësimin përfundimtar të çështjes, në kushtet kur çështja i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, nga ku nuk kanë rezultuar problematika procedurale, si dhe nuk kanë ardhur pasoja rënduese për palën, mungesa e dokumentuar zyrtarisht e urdhrin për shtyrjen e hetimeve nuk vlerësohet si mangësi procedurale me pasoje për subjektin [...], si dhe për mosparaqitjen e ankimit [...] vlerëson se, pavarësisht se deklaramet e subjektit mund të jenë të vërteta nisur nga data e krijimit të dokumentit të printuar që ai paraqiti, nuk provohet zyrtarisht fakti që të jetë ushtruar ankim ndaj vendimit të pushimit të çështjes nga gjykata. Gjithsesi, nga përmbajtja e nenit 408 të Kodit të Procedurës Penale, duket se ushtrimi i të drejtës së ankimit është një tagër që i lihet vlerësimit të prokurorit [...].*

²¹ Shkresa me nr. *** prot., datë **.5.2023.

²² Referohuni faqes 45 të vendimit të Komisionit.

21.6 Komisioneri Publik, për sa më sipër, vlerëson se, si mungesa e zgjatjes së afatit të hetimeve për periudhën **2.2015 – **5.2015, si detyrim i nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, me pasoja në papërdorshmërinë e provave, ashtu edhe mungesa e dokumentimit të përgatitjes së ankimit nga subjekti i rivlerësimit, si rregullim i parashikuar nga neni 329 i Kodit të Procedurës Penale, janë mangësi për t'u mbajtur në konsideratë në vlerësimin e përgjithshëm sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

22. Denoncim²³ i shtetasit *.***.**

22.1 Komisioni, në funksion të hetimit administrativ të denoncimit të shtetasit ***.***, ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë²⁴, vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë me nr.***, datë **.1.2017, në lidhje me procedimin penal nr. ***, të vitit 2014, në ngarkim të shtetasit ***.***.

22.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë ka marrë në shqyrtim çështjen penale që i përket të pandehurit ***.***, akuzuar për veprën penale të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, ku prokuror është subjekti i rivlerësimit, z. Gjini. Gjykata, me vendimin nr. **, datë **.1.2017, ka vendosur: [...] *Pushimin e çështjes penale në ngarkim të pandehurit ***.***, akuzuar për veprën penale të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, për shkak se përfiton nga amnistia me ligjin nr.141/2016, “Për dhënie amnistie” [...].*

22.3 Referuar akteve në dosjen e këtij procedimi penal, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se subjekti, në vitin 2015, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal²⁵, në ngarkim të shtetasit ***.***, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit ***.***, për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, ndaj shtetasve ***.*** dhe ***.***, ndërsa në datën **.6.2016, subjekti i rivlerësimit, z. Gjini, ka vendosur të marrë si të pandehur shtetasin ***.***, duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vetëgjyqësia” dhe, në datën **.6.2016, ka dërguar për gjykim procedimin penal nr. **, të vitit 2015, në ngarkim të tij.

22.4 Komisioni, në aktin “Rezultatet e hetimit ...”, përshkruan kronologjikisht veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe i kërkon të japë sqarime e prova për të provuar të kundërtën e barrës së provës lidhur me këto konstatime: [...] (i) *në përfundim të hetimeve paraprahe, subjekti nuk ka proceduar me pushimin e akuzës/apo dërgimin për gjykim të shtetasit ***.***, sipas parashikimeve të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale*²⁶, *në ngarkim të të cilit kishte regjistruar procedimin penal për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal;*(ii) *Në mënyrë të paqartë dhe të argumentuar, pavarësisht kallëzimit penal të shtetasit ***.***, për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, për të dy shtetasit ***.*** dhe ***.***, subjekti ka regjistruar procedimin penal vetëm për shtetasin ***.***, ndërkohë që shtetasi ***.*** është marrë më vonë si i pandehur dhe vetëm ai është dërguar për gjykim për veprën penale “Vetëgjyqësia”, duke ndryshuar në këtë mënyrë dhe cilësimin juridik të veprës penale për të cilën ishin kallëzuar këta shtetas dhe duke i paraprirë amnistisë që pritej të miratohej, ndërkohë që vepra penale “Shkatërrimi i pronës” nuk ishte e përfshirë në veprat penale që amnistoheshin;*(iii) *Në dosje nuk rezultojnë të dokumentuara përgjigjet e organit procedues për kërkesat e palëve sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale;*(iv) *Në dosje nuk ka vendime për zgjatjen e afatit të hetimeve, sipas parashikimit të nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, duke*

²³ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë **.3.2018 dhe me nr. *** prot., datë **.4.2019.

²⁴ Shkresa me nr. *** prot, datë **.5.2023 dhe shkresa me nr.*** prot., datë **.4.2022.

²⁵ Neni 150, “Shkatërrimi i pronës”: *Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës, kur pasojat materiale nuk janë të lehta, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.*

²⁶ 2. Prokurori, pasi shqyrton aktet dhe sigurohet që i pandehuri ose mbrojtësi është njohur me to, vendos, sipas rastit, pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykatë.

qenë se afati tremujor, sipas parashikimit të nenit 323/1 e Kodit të Procedurës Penale, ka kaluar [...]. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë përgjigje në Parashtrimet e datës 3.7.2023.

22.5 Komisioni, lidhur me barrën e provës, evidentuar në aktin “Rezultatet e hetimit ...”, sa më lart, ka arritur në këto përfundime²⁷: (i) lidhur me ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale [...] çmohet se vlerësimi në lidhje me ndryshimin e kualifikimit ligjor nuk është i një natyre procedurale, por lidhet me themelin e çështjes dhe, si e tillë, është jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit. Për më tepër, pas dërgimit për gjykim të çështjes, gjykata nuk i ka dhënë veprës penale një kualifikim të ndryshëm nga ai i subjektit në cilësinë e prokurorit [...]; (ii) Lidhur me konstatimin se në dosje nuk ka vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve [...]. Në vlerësimin përfundimtar u çmua se, për sa kohë shënimi i emrit të shtetasit ***,***, në urdhrin e regjistrimit të procedimit penal si person që i atribuohet vepra penale, u konsiderua të ketë qenë një lapsus, pasi regjistrimi i veprës penale ka qenë pa autor, sikurse është arsyetuar më sipër, si dhe në kushtet kur afati i hetimeve lidhet pikërisht me këtë moment, konstatimi mbi mungesën e një vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve nuk qëndron [...]; (iii) Lidhur me mungesën e përgjigjes të organit procedues për kërkesat e palëve, sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale [...] Në rastin konkret, pavarësisht argumenteve të subjektit se mosmarrja e një vendimi sipas kësaj dispozite ligjore ka ardhur për shkak të nevojës së ruajtjes së sekretit hetimor apo vlerësimin si të pabazuara në ligj e prova të kërkesave të tjera, duke iu referuar nenit 278 të Kodit të Procedurës Penale, në përfundim, Komisioni çmoi se subjekti duhet të shprehej me vendim, por nuk e konsideron këtë si një gabim thelbësor, serioz dhe të përsëritur, në mënyrë të tillë që të jetë kthyer në një model pune për subjektin e rivlerësimit dhe, për pasojë, problematika e evidentuar që i përket një rasti të vetëm, nuk i cenon aftësitë profesionale të subjektit në atë nivel që mund të bëhet shkak për penalizim të tij [...].

22.6 Komisioneri Publik, për sa më sipër, vlerëson se mungesa e zgjatjes së afatit të hetimeve është evidente dhe nuk është i besueshëm pretendimi për lapsus në urdhrin e regjistrimit penal në emër të një shtetasi tjetër nga ai i dërguar për gjykim, sa kohë kemi të bëjmë me një veprim procedural që gjen rregullim të shprehur në ligj, me rëndësi të shtuar, të cilit i kushtohet një kujdes i posaçëm, sa kohë prej kryerjes së tij rrjedhin një sërë detyrimesh për t’u përmbushur nga organi procedues. Gjithashtu qëndron dhe konkluzioni i Komisionit për sa i përket detyrimeve që rrjedhin prej nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, duke shtuar se dispozita kërkon nga organi procedues dalje me vendim, i cili nuk rezulton të jetë marrë në rastin në shqyrtim, mangësi për t’u mbajtur në konsideratë në vlerësimin e përgjithshëm sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Kërkimi i ankimit

22.7 Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

22.8 Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

22.9 Bazuar në nenet Ç, D, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

²⁷ Referohuni faqeve 42-43 të vendimit të Komisionit.

22.10 Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 682, datë 10.7.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Enklid Gjini.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA